



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2019-02

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 26 shkurt 2019

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## VENDIM

**Për caktimin e një gjykatësi të vetëm në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit për rishikimin e vendimit të Administratores të datës 18 shkurt 2019 në lidhje me ndihmën juridike**

---

**Gjykatës i vetëm**

Gjykatësi Nikola Giju

**Parashtruesi**

Z. Ruzhdi Saramati

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me anë të këtij vendimi cakton një gjykatës të vetëm për rishikimin e vendimit të Administratores të datës 18 shkurt 2019, për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike të z. Ruzhdi Saramati (“Parashtruesi”).

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 shkurt 2019, Administratorja nxori një vendim për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike të dorëzuar nga Parashtruesi.<sup>1</sup>
2. Më 23 shkurt 2019, Parashtruesi dorëzoi një kërkesë për rishikimin e vendimit të Administratores (“Kërkesa”),<sup>2</sup> e cila u mor nga Kryetarja më 25 shkurt 2019.<sup>3</sup>

## II. LIGJI I ZBATUESHËM

3. Në bazë të nenit 34(6)-(7) të Ligjit, njësitë e Zyrës Administrative administrojnë një sistem të ndihmës juridike për përfaqësimin e personave të varfër ose pjesërisht të varfër para Dhomave të Specializuara.
4. Udhëzuesi i Përkohshëm i Punës mbi kërkesat për caktimin e mbrojtësve dhe për ndihmë juridike (“Rregullorja e Përkohshme për Ndihmë Juridike”)<sup>4</sup> përcakton kushtet dhe procedurën për kërkimin e ndihmës juridike dhe për miratimin apo refuzimin e saj.

---

<sup>1</sup> KSC/REG/IOR/1632, 18 shkurt 2019.

<sup>2</sup> KC-BC-2019-02, F00001, z. Ruzhdi Saramati, *Kërkesë për rishikimin e vendimit të Administratores Ref: KSC/REG/IOR/1632*, 23 shkurt 2019, publike.

<sup>3</sup> DHSK, shpërndarë përmes postës së brendshme elektronike nga Njësia për Administrimin e Gjykatës, 25 shkurt 2019, marrë në orën 18:33 (origjinali në shqipe) dhe 18:41 (përkthimi në anglishte).

<sup>4</sup> KSC-BD-06, Administratorja, *Rregullorja e Përkohshme për Ndihmë Juridike – Udhëzues Pune mbi Kërkesat për Caktim të Mbrojtësit dhe për Ndihmë Juridike*, 21 dhjetor 2018, limite.

5. Në bazë të rregullave 11 and 17 të Rregullores së Përkohshme për Ndhimë Juridike, çdo vendim i Administratores, përfshirë edhe në lidhje me kërkesat për ndihmë juridike, mund t'i nënshtrohet rishikimit nga një panel kompetent ose një gjykatës i vetëm, sipas rastit, caktuar për këtë qëllim nga Kryetarja pas marrjes së kërkesës së personit që është objekt i vendimit, kërkesë e cila parashtrohet brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e njoftimit për vendimin.

6. Neni 25(1)(f) i Ligjit parashikon që Dhomat përbëhen, *inter alia* nga gjykatës individualë që sipas nevojës kryejnë detyra të tjera që kërkohen me këtë Ligj.

7. Neni 33(2) i Ligjit parashikon që Kryetarja mund të caktojë një gjykatës të vetëm nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Regjistri") në përputhje me Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri ("Rregullorja për Caktimin"), për t'u marrë me një çështje e cila, sipas mendimit të Kryetares, kërkon caktimin e një gjykatësi i cili nuk është gjykatës i procedurës paraprake. Caktimet sipas nenit 33(2) të Ligjit janë me natyrë të përkohshme dhe përfundojnë sapo të jetë zgjidhur çështja për të cilën janë bërë ato caktime.

8. Sipas rregullës 3(4) të Rregullores për Caktimin, Kryetarja lëshon një vendim publik për caktimin e gjykatësve në një panel, ku përcaktohen kriteret për caktim të parapara në rregullën 5(2) të Rregullores për Caktimin.

### III. CAKTIMI I NJË GJYKATËSI TË VETËM

9. Kërkesa ngre një çështje e cila aktualisht nuk i përket asnjë faze të procedurave sipas neneve 25(1)(a)-(e) dhe 33(1) të Ligjit dhe, për këtë arsye, nuk ekziston një 'panel kompetent' sipas përcaktimit të rregullës 11 të Rregullores së Përkohshme për Ndhimë Juridike, për t'u ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës.

10. Duke u nisur nga kjo dhe në përputhje me nenet 25(1)(f) dhe 33(2) të Ligjit, është e nevojshme të caktohet një gjykatës i vetëm për shqyrtimin e kërkesës.

11. Pas shqyrtimit të kritereve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin, caktohet një gjykatës i vetëm mbi bazën e përvojës së tij përkatëse si dhe në bazë të disponueshmërisë së tij të tanishme.

**PËR KËTO ARSYE, NË VIJIM KRYETARJA CAKTON**

**gjykatësin Nikola Giju**

si gjykatës të vetëm për rishikimin e vendimit të Administratores të datës 18 shkurt 2019, për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike të z. Ruzhdi Saramati.

/nënshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,  
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 26 shkurt 2019

Në Hagë, Holandë